

AROMANIAN SONGS FROM DRENOVA. KËNGË ARUMUNE TË DRENOVËS

PËRGATITUR NGA JOSIF E MIKAELA MINGA

Roma: Squilibri (2018)

Aromanian Songs from Drenova/Këngë arumune të Drenovës, është një album në CD, i përgatitur nga Josif Minga dhe Mikaela Minga dhe i publikuar nga botuesi *Squilibri* me qendër në Romë/Itali. Albumi dokumenton një praktikë ekspresive siç është ajo e këndimit shumëzërësh të komunitetit vllah ose arumun të zonës së Drenovës, në afërsi të Korçës dhe përmban shtatëmbëdhjetë njësi. Nga këto, vetëm një është instrumentale, e titulluar *Valle e kapedan Ilias*, ndërsa të tjerat janë këngë të kënduara sipas praktikës tradicionale; në mënyrë pastërtishtë vokale, me një marrës që udhëheq fillin muzikor, një prerës që i përgjigjet atij në mënyrë dialoguese, dhe një grup që mban ison, zërin e mbajtur në formë pedali, që përbën themelin tonal mbi të cilin mbështetet e gjithë ngrehina muzikore.

Albumi mund të konsiderohet si një sipërmarrje

dyfish etike. Së pari, në ndryshim nga praktika e sotme etnomuzikologjike që ka në qendër të vet studimin e *njerëzve* që bëjnë muzikë, në etnomuzikologjinë shqiptare është trashëguar një model i kundërt, me fokus tek *muzika* e bërë nga njerëzit, duke e konceptuar bartësin në një rol dytësor, kryesisht si përçues i thjeshtë i traditës, kjo e fundit e konceptuar në mënyrë statike si “e pandryshuar”, ose në rastin më të mirë me “ndryshime shumë të vogla në periudha të gjata kohore.” Albumi në fjalë, në të kundërt, i ka bartësit në qendër të vet, jo vetëm në planin e nismës për realizimin, por edhe në përzgjedhjen e repertorit si dhe në alternimin e roleve në numrat e regjistruar, si një mënyrë për të nxjerrë në pah stilet e veçanta të të kënduarit të secilit.

Së dyti, nisma merr një vlerë të veçantë për vetë faktin se dokumenton trashëgimi muzikore

të një minoriteti, sferë në të cilën gjithashtu ka akoma shumë për të bërë. Dalja e albumit përkoi rastësisht me njohjen për herë të parë nga ana e shtetit shqiptar të komunitetit arumun si pakicë kombëtare, përkundrejt statusit të mëparshëm si pakicë kulturore, pa folur këtu për periudhën totalitare ku ata nuk u njohën aspak si minoritet. Paradoksi është se bëhet fjalë për një komunitet me një histori të çmuar të bashkëjetesës në Shqipëri. Dihet, për shembull, roli i veçantë historik i autorëve me prejardhje arumune në kulturën e shkrimit shqip, përkatësisht ndikimi i tyre i ndërsjellë në lëvrimin e shqipes dhe të arumanishtes, pikërisht në ato treva me bashkësi multietnike të besimit ortodoks, ku greqishtja (kishtare-bizantine) gjallonte si gjuhë liturgjike duke gëzuar si e tillë edhe statusin e gjuhës së prestigjit kulturor. Mbase edhe më i qenësishëm ka qenë kontributi i arumunëve në traditat muzikore, pasi, për vetë stilin nomad të jetës që kanë pasur tradicionalisht, ata kanë luajtur një rol përçuesi të këngës, duke e qarkulluar atë nga një zonë në tjetrën. Flet shumë fakti se i kanë kënduar këngët jo

vetëm në gjuhën amtare, por edhe në shqip.

Edhe në këtë album është përfshirë një këngë shqip, ndërsa këngët e tjera këndohen në arumanisht. Në tërësi ato i përgjigjen trezërëshit tipik tosk, ku spikat vokaliteti dhe lirizmi i linjave melodike, ndryshe nga këndimi më deklamativ lab. Protagonistët janë përkujdesur madje, që t'i qëndrojnë ngushtësisht besnikë stilit të të kënduarit të zonës së tyre specifike, duke u distancuar nga këndimet arumune të krahinave të tjera. Një praktikë jo e zakonitë dokumentohet nga numri nëntë *Di cãnd deadi laia lunã* (*Hënë moj e zezë bënë*), ku Aleks Mihallari (l. 1935), pjesëtari më i moshuar i grupit dhe mbase vokali më i spikatur i tij, interpreton vetë edhe marrësin edhe prerësin, i mbështetur nga grupi që mban izon.

CD-ja shoqërohet nga një libërth i përgatitur me kujdes nga muzikologia Mikaela Minga, në të cilin, krahas një prezantimi të përmbledhur të albumit dhe të historisë e traditës së komunitetit, paraqiten interpretuesit e këngëve dhe tekstet e tyre, bashkë me përkthimet përkatëse në shqip dhe

në anglisht. Libërthi përmban edhe një numër fotosh, të cilat do të kishte qenë e dëshirueshme mbase të plotësoshin me ndonjë shënim informues.

Albumi paraqet një ekuilibër të mirë ndërmjet performancës së kuruar artistike dhe funksionit dokumentues, kjo pikë e dytë veçanërisht e rëndësishme, pasi bëhet fjalë për brezin e fundit që e praktikon këndimin shumëzërësh tradicional në këtë komunitet. Në një kohë kur shoqëria shqiptare duket e dorëzuar pa kushte ndaj ideologjisë së “tregut”, ky album risjell në vëmendje faktin se, krahas hulumtimeve studimore, angazhimi dhe “puna kulturore” në drejtim të ruajtjes dhe mbështetjes së traditave kulturore

është gjithashtu një kontribut i çmuar që studiuesit mund dhe duhet të japin. Në fund të fundit, interpretimet edhe mund të vjetrohen, ndërsa përvoja njerëzore mbetet përherë aktuale.

Në mbyllje, konstatojmë me keqardhje se, ashtu si një shekull më parë, edhe këtij albumi iu desh të kalonte përtej detit në mënyrë që të mund të botohej me të gjithë parametrat e duhur. Le të shpresojmë që kjo t'i vijë në ndihmë albumit që të përmbushë një nga synimet e tij, atë të ndërmjetësit për publikun e interesuar ndërkombëtar, të tërhequr jo pak nga polifonia tradicionale shqiptare që nga shpallja e saj si pjesë e trashëgimisë së UNESCO-s.

Edmir Ballgjati

Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit